




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN



Numri i lëndës: 2022:166409
 Datë: 13.06.2023
 Numri i dokumentit: 04385664
K-148-04/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DIVIZIONI PËR KUNDERVAJTJE, gjyqtari Nazim Vllaço me sekretaren juridik Shykran Celina, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Habib Morina pronare B. I - NTSH “Patroni” me seli në Prizren, për shkak të kundërvajtjes nga neni 13 pika 2 të Ligjit për Tregtin me Produkte të Naftës dhe Korbura teve të Ripërtërishme nr. 08/L-018 të ndëshkuar sipas nenit 19 par. 8 të po këtij Ligji, e në bazë të nenit 31, 35, 55, 77, 86, 124 dhe 129 të Ligjit mbi Kundërvajtjet nr.05/L-087, me dt. **13.06.2023** merr këtë:

A K T G J Y K I M

I Pandehuri: Habib Morina pronare B. I - NTSH “Patroni” me seli në Prizren – Arbanë.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse me datën 27.07.2022, gjate inspektimit të kryer nga ana e Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Prishtinë në subjektin ekonomik B. I - NTSH “Patroni” me seli në Prizren – Arbanë, shitje me pakicë e NDN, rezulton se produkti i testuar dizeli dhe benzina nuk është konformë me dispozitat regullative të përcaktuara me udhëzim administrativë nr. 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta në naftës pika e ndezjes është 43 °C, ndërsa vlera e lejuar minimale është 55 °C, të konstatuara nga analizat e kryera nga kompania SIERRA – Lab SH.P.K.

Me te cilin veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 13 pika 2 të Ligjit për Tregtin me Produkte të Naftës dhe Korbura teve të Ripërtërishme nr. 08/L-018 të ndëshkuar sipas nenit 19 par. 8 të po këtij Ligji

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të lartshënuar .

D Ë N O H E T

Me dënim me gjobe prej 5.000 euro /. pesëmijë euro /.

I pandehura obligohet që gjobën e shqiptuar dhe shumën prej 5 Euro, në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit, a po varësisht nga gjendja ekonomike, mundë të e paguan edhe me 2 këste duke u bazuar në nenin 30 par.1 të Ligjit për kundërvajtje, Nr.05/L-087, në të kundërtën gjoba e shqiptuar dhe shpenzimet e cekura më lartë, do të arkëtohen me dhunë në bazë të dispozitave mbi arkëtimin me dhunë të

tatimit, në vështrimin të nenit 163 par. 4 të ligjit për Kundërvajtje. I pandehuri poashtu, obligohet që pas kryerje së pagesës ta njoftoj këtë gjykatë.

Shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes janë shqiptuar në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Kundërvajtje.

A r s y e t i m i

Sipas kërkesës së Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Prishtinë me nr. 19/2022 të dt. 08.08.2022, është ngritur procedura kundërvajtëse kundër te pandehurit Habib Morina pronare B. I - NTSH "Patroni" me seli në Prizren, për shkak të kundërvajtjes nga neni 13 pika 2 të Ligjit për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Korbura të Ripërtërishme nr. 08/L-018 të ndëshkuar sipas nenit 19 par. 8 të po këtij Ligji, me propozim që i njëjti shpallet përgjegjës dhe dënohet sipas dispozitave ligjore.

I pandehuri në seancën verbale të dt.06.02.2023 ka theksuar se: me datën 27.07.2022, në N.T.SH "Patroni" njësi në Prizren në lagjen Arbana, kanë qenë inspektorët MINT-it për kontroll inspektiv dhe kishin konstatuar se dizeli kishte rezultuar jo konform dispozitave ligjore. Inspektorët më kanë dhënë afat që të bëjë kërkesë për super analizë të inspektoratit gjegjë, unë nuk e kam bërë sepse Kompania e njejtë bën super analiza dhe Kompania e cila merr mostërën është e njejtë. Prandaj kemi kërkuar që këtë super analizë ta bën një Kompani tjetër e jo Ministria e Tregtisë, në lidhur me këtë kemi bërë kërkesë me shkrim dhe me gojë.

Ne kemi bërë një kërkesë për përmirësimin e cilësisë, tek Ministria e Industrisë dhe Tregtisë dhe atë me dt. 02.08.2022.

Nga Inspektorati i Tregut i Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë, është aprovuar kërkesa për përmirësim të karburanteve, dhe na kanë njoftuar se do të mbikqyrin procesin e përmirësimit të dizelit dhe pas përmirësimit ata kishin konstatuar se dizeli është jo konform.

Në cilësi të dëshmitarit është marrë deklarata e inspektore Fexhrie Salihu i cili në tërësi ka mbetur pranë të dhënave të përpiluara në procesverbalin nga vendi i ngjarjes, duke theksuar se me dt. 27.07.2022 kemi marrur mostra për derivatet e naftës në bashkupunim me trupin inspektues kemi marrur mostra në pikën shitëse me pakicë të derivative të naftës në operatorin ekonomik Patroni, njësi në Arbanë në Prizren, pas arritjes së raporti të testimit rezulton se derivati i testuar dizel është jo konformë Udhëzimit Administrativ 01/2017, operatori ekonomik është njoftuar me rezultatin jo konformë dhe iu është dhënë mundësia e kërkesës për superanalizë, në afat prej 3 ditësh, operatori ekonomik gjatë njoftimit është furnizuar me derivatin e ri dhe është marrë përsëri një mostër për verifikimin e cilësisë, ku përsëri ka rezultuar jo konformë udhëzimit administrativ, dhe iu është dhënë mundësia e super analizës dhe përmirësimi i produktit operatori ekonomik në bazë të kërkesës nr. 4713 ka bërë kërkesë për përmirësimin e produktit. Inspektorati i tregut ka aprovuar kërkesën për përmirësim të produktit dhe inspektorët të jenë prezentë në mbikqyrjen e këtij procesi deri në përmirësimin e produktit.

Në procedurën e provave është bërë leximi i të dhënave në procesverbalin e inspektorit të dt. 27.07.2022 me nr. 22/00526, me të cilin inspektori ka urdhëruar subjektin ekonomik që në afat prej 5 ditësh ta prezentojë raportin e cilësisë për mostrat e marrura për dizel dhe ta prezentojë faturën e fundit të furnizimit për antifrizë, në bazë të analizës së bërë lidhur me cilësinë e naftës nga ana e SH.P.K "SIERRA – Lab" të dt. 29.07.2022, është konstatuar se pika e ndezjes të naftës nuk është konform Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017.

Në kontrollin e dt. 01.08.2022, i pandehuri urdhërohet ta përmirësojë cilësinë e naftës dhe lidhur me këtë ta njoftoj Inspektoratin e Tregut në afat prej 3 ditësh.

NTSH. "Patroni" me dt. 02.08.2022, ka ushtruar kërkesë Inspektoratit të Tregut për përmirësim të cilësisë, dhe lidhur me këtë nga Inspektorati i Tregut është aprovuar kërkesa për përmirësim të karboranteve dhe iu është kthyer përgjegjja se inspektorati i tregut dhe trupat inspektuese nuk mund të përfshihen në procesin e përmirësimit të cilësisë të produkteve dizel me arsyetim se realizimi i këtij procesi është në përgjegjësi të operatorit ekonomik, dhe se inspektorati i tregut do të jetë prezentë për të bërë mbikqyrjen e procesit të përmirësimit të cilësisë të produkteve dizel për dt. 02.08.2022.

Neni 13 par. 2 të Ligjit për Tregtinë me Produktet e Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme nr. 08/L-018, parasheh: subjektet kanë për detyrë të garantojnë cilësinë e karboranteve që importojnë ose tregtojnë në Republikën e Kosovës.

Neni 19 par. 8 parasheh: kushdo që në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 13 mashtronë me sasin dhe cilësinë e produkteve të naftës dënohet me gjobë.

Gjykata nga provat e administruara duke i analizuar secilën veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku pa dyshim ka vërtetuar se në veprimet e të pandehurës qëndrojnë elementet e veprës kundërvajtëse e cila i vihet në barrë, andaj të pandehurit e shpalli përgjegjës dhe dënoi sipas ligjit.

Në përputhje me nenin 31 të Ligjit mbi Kundërvajtje, me rastin e caktimit të sanksionit kundërvajtës është shqiptuar gjoba si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e cila konsiderohet se është përcaktuar si pas shkallës së përgjegjësisë, peshës së veprës, si rrethanave në të cilat është kryer vepra kundërvajtëse.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga një ekzemplarë të këtij aktgjykimi do t'i dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES
2022:166409, 13.06.2023**

K-148-04/2022

**Sekretarja juridike
Shykran Celina**

dt.13.06.2023

**Gjyqtari
Nazim Vllaço**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 (tetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Divizionit të kundërvajtjes, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.